



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK  
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT**

**Të dhëna mbi Vendimin**

**Nr. 103, datë 09.10.2018**

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (në vijim "LPP"), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" SHPK nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.

**I. Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa):**

"ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" SHPK me NIPT K91326028I, me adresë: Rruga "Rreshit Petrela", Kompleksi Usluga, Tiranë.

**II. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:**

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" SHPK ka nisur mbi bazën e kërkesës datë 18.04.2018, të dërguar nga shoqëria "Shpresa" Shpk, me të cilën kjo e fundit i propozon APP-së nisjen e hetimit administrativ ndaj operatorit ekonomik "ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" SHPK, për përjashtimin e tij nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për keqinformim dhe paraqitje të dokumentave që përmbajnë të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi.

**III. Gjetjet:**

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e keqinformimit dhe paraqitjes së dokumentave që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, sipas parashikimeve të nenit 13/3/a të LPP.

#### **IV. Masat:**

Me Vendimin Nr. 103, datë 09.10.2018, Agjencia e Prokurimit Publik ka vendosur të përjashtojë për një periudhë 3 (tre) vjeçare operatorin ekonomik "ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" SHPK, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për arsye se, ky operator ekonomik ka përfituar nga fondet publike, duke përdorur dokumenta që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, pasi është shpallur fitues dhe ka lidhur kontratë, për objektin përkatës të prokurimit.